



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Gusht 2026

BULETINI

m u j o r



www.mod.gov.al





Nufi takon sportistët elitarë të Forcave të Armatosura, do të organizojnë klasat sportive në AFA

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi zhvilloi një takim me sportistët elitarë, pjesë e Forcave të Armatosura, ku u diskutua mbi nismën për përfshirjen e tyre në organizimin e klasave sportive si program ekstrakurrikular në strukturat dhe Akademinë e Forcave të Armatosura.

"Përvoja e sportistëve elitarë do të kontribuojë në përmirësimin e metodave të stërvitjes, forcimin e disiplinës, frymës së garës dhe përgatitjes për përballimin e sfidave operacionale, emergjencave civile dhe misionëve ndërkombëtare." tha Nufi.





Ministri i Mbrojtjes Nufi takon homologun italian Guido Crosetto në Romë: “Thellojmë bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes”

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi zhvilloi një takim me Ministrin e Mbrojtjes të Italisë, Guido Crosetto, ku në qendër të bashkëbisedimit ishte forcimi i bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.

Ministri Nufi vlerësoi Italinë si një partnere të rëndësishme strategjike të Shqipërisë dhe një aleate të çmuar në kuadër të NATO-s, duke nënvizuar rëndësinë e partneritetit të ngushtë mes dy vendeve në përbashkëtimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë.



Gjenova, nënshkruhet Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë "Fincantieri Albania"

Në Gjenova të Italisë në Divizionin e Anijeve Detare të kompanisë FINCANTIERI u hodh një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit strategjik mes Shqipërisë dhe Italisë, me nënshkrimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë "Fincantieri Albania", me seli në Vlorë.

Partneriteti përfaqëson një investim të rëndësishëm në zhvillimin e industrisë detare shqiptare, transferimin e teknologjisë, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese në vend.



Itali, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi, vizitë në Divizionin e Anijeve Detare të FINCANTIERI

Në kuadër të partneritetit me FINCANTIERI-n, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi dhe delegacioni që e shoqëronte zhvilluan një vizitë në Divizionin e Anijeve Detare të kompanisë në Muggiano, një prej qendrave më të rëndësishme të ndërtimit të anijeve ushtarake dhe sistemeve detare në Evropë.

Gjatë vizitës në kantar, ministri u njoh nga afër me proceset e projektimit, prodhimit dhe integritetit të platformave moderne detare, si dhe me praktikën më të mirë të FINCANTIERI-t, në funksion të zbatimit të projektit të përbashkët "Fincantieri Albania" në Vlorë.





Në frontin e zjarrit në malin e Krujës, Ministri Nufi ndjek në terren situatën, qindra efektivë pranë komunitetit

Në zonën e Abazes në Krujë, Ministri Nufi bashkë me Ministrin e Brendshëm Besfort Lamallari, Drejtorin e AKMC dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Zjarrfikësve ndoqi nga afër situatën e zjarrit të shkaktuar fatkeqësisht nga dora e njeriut.

Për izolimin dhe shuarjen e vatrave të zjarrit në Krujë, me këmbëngulje dhe sakrificë të jashtëzakonshme u angazhuan maksimalisht qindra efektivë, forcat komando, pilotët e Forcës Ajrore bashkë me forcat operacionale të strukturave vendore.

Të gjitha strukturat punuan të koordinuara për kufizimin e përhapjes së flakëve, mbrojtjen e qytetarëve, banesave, bizneseve dhe mjedisit, deri në vënien e plotë të situatës nën kontroll.



Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi takon pilotët e Forcës Ajrore në Bazën Ajrore të Farkës

Për të shprehur mirënjohjen për punën e palodhur që bëjnë çdo ditë, veçanërisht në përballimin e situatave të krijuara nga zjarret gjatë sezonit veror, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi zhvilloi një takim falënderues me pilotët dhe teknikët e Forcës Ajrore në Bazën Ajrore të Farkës.

Pilotët dhe ekuipazhet e Forcës Ajrore janë çdo ditë në krye të detyrës, duke kontribuar me profesionalizëm dhe devotshmëri të lartë dhe në mbrojtje të jetës, pronës dhe pasurive tona natyrore.

Përmes ndërhyrjeve nga ajri, ata kanë kontribuar në izolimin dhe neutralizimin e vatrave më problematike, duke ndihmuar në kufizimin e përhapjes së flakëve drejt zonave të banuara dhe në mbrojtjen e pasurive natyrore.



Forcat e Armatosura analizojnë punën e 6-mujorit të parë të këtij viti, në fokus rezultatet dhe prioritetet e zhvillimit

Forcat e Armatosura kanë realizuar me sukses objektivat kryesore të 6-mujorit të parë të këtij viti. Kjo u bë e ditur gjatë analizës së punës në praninë e Ministrit të Mbrojtjes, Ermal Nufi; Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjenerallejtënant Arben Kingji; komandantëve dhe drejtorëve të strukturave të Forcave të Armatosura.

Krahas ruajtjes së sigurisë dhe gatishmërisë operacionale, analiza evidentoi progres në rekrutim, stërvitje, operacione, modernizim, infrastrukturë dhe administrimin e burimeve.

Ndërkohë, riorganizimi i strukturave ka përmirësuar efektivitetin e komandimit dhe përdorimin e burimeve, ndërsa bashkëpunimi me NATO-n, SHBA dhe partnerët rajonalë ka forcuar përgatitjen dhe ndërveprueshmërinë e forcave.



Fshati Halil në Krujë, Ministri Nufi në terren ndjek situatën, shpreh mirënjohje për punën e efektivëve të angazhuar

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, ishte i pranishëm në fshatin Halil të Krujës, ku situata u përkeqësua pasi flakët dolën jashtë kontrollit dhe rrezikuan banesat e zonës.

Ministri ndoqi nga afër situatën dhe operacionin për shuarjen e zjarrit, ndërsa shprehu mirënjohjen dhe respektin për efektivët e angazhuar në terren në operacionin për shuarjen e vatrave të zjarrit.



Ministri belg i Mbrojtjes zgjedh Shqipërinë për pushime, në Vlorë e pret homologu Ermal Nufi

Ministri belg i Mbrojtjes, Theo Francken, i cili zgjodhi vendin tonë për pushime së bashku me familjen, është takuar në Vlorë me ministrin Ermal Nufi.

Takimin e ka bërë të ditur vetë Nufi përmes një postimi në rrjetet sociale, ku ka publikuar edhe foto.

“Një takim i ngrohtë për të ndarë disa momente larg angazhimeve zyrtare, si dhe një mundësi e mirë për të forcuar miqësinë dhe bashkëpunimin në kuadër të prioriteve të përbashkëta mes dy vendeve tona”, shkruan Nufi.



Ministri Nufi për Guna Tactical: “Investim me rëndësi në industrinë shqiptare të mbrojtjes”

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi ka ndarë pamje nga kantieri i punës në kompaninë "Guna Tactical", ku po ndërtohet një nga investimet më të rëndësishme të partneritetit publik-privat në industrinë shqiptare të mbrojtjes.

“Guna Tactical” do të prodhojë veshje ushtarake jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin dhe për vendet e tjera.” tha ministri Nufi.

Sipas tij, mbi 290 punonjës janë të angazhuar sot në këtë industri, duke cilësuar se numri i tyre do shkojë mbi 1,000 në momentin që kantieri do të jetë plotësisht funksional.

Ndër të tjera, ministri Nufi vendos theksin tek punësimi i njerëzve në këtë industri që jo vetëm gjeneron të ardhura, por punëson njerëz dhe ndikon në komunitet çdo ditë.





Ministri Nufi në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile: "Monitorim dhe koordinim pa ndërprerje e situatës së zjarreve"

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi ishte në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, pjesë e AKMC, nga ku monitorohet në mënyrë të pandërprerë situata në të gjithë territorin e vendit dhe koordinohen strukturat për përballimin e emergjencave civile.

Përmes një video-mesazhi, Ministri Nufi theksoi rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm 24/7 mes strukturave vendore dhe qendrore përfshirë zjarrfikësit dhe Forcat e Armatosura, në përballimin e zjarreve dhe emergjencave civile.





Forcat e Armatosura në vijën e parë të përballimit të zjarreve në vend

Rreth 4,000 efektivë të Forcave të Armatosura (FA), të mbështetur nga 4 helikopterë dhe 2 avionë Air Tractor, 331 mjete transporti, 31 ambulanca, 77 mjete zjarrfikëse, 1 buldozer, kanë qenë të angazhuar gjatë muajit gusht 2026 për përballimin e situatës së zjarreve.

Të gjitha strukturat e FA kanë punuar me intensitet të lartë në operacionet për përballimin e situatës së zjarreve në disa zona të vendit, në mbështetje të autoriteteve civile, duke ndërhyrë në vatrat aktive dhe duke kontribuar në mbrojtjen e komuniteteve, banesave, bizneseve dhe mjedisit.

Operacionet janë zhvilluar në koordinim të plotë me AKMC, Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, Policinë e Shtetit, strukturat e Mbrojtjes së Zonave të Mbrojtura, Shërbimin Pyjor, strukturat bashkiake dhe vullnetarët.



SHSHPFA në Komandën e Forcës Tokësore, në fokus masat për stërvitjen certifikuese të Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjenerallejtënant Arben Kingji zhvilloi një takim në Komandën e Forcës Tokësore me komandantët e njësive dhe personelin përgjegjës për masat e marra në prag të stërvitjes certifikuese të Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL).

Në fokus të këtij takimi ishte vlerësimi i nivelit të përgatitjes dhe të gatishmërisë së strukturës për procesin e certifikimit “Të gatshëm për mision”, në dispozicion të strukturave operacionale të NATO-s.





Përdorimi i mjeteve ajrore pa pilot përbën një komponent të rëndësishëm të kapaciteteve të FA

Përdorimi i mjeteve ajrore pa pilot përbën një komponent të rëndësishëm të kapaciteteve të Forcave të Armatosura në mbështetje të operacioneve për mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit.

Droni Bayraktar TB2 i Forcës Ajrore kryen misione monitorimi ditën dhe natën, duke transmetuar në kohë reale informacion mbi vatrat e zjarrit, përhapjen e flakëve dhe lëvizjen e helikopterëve të angazhuar në të gjithë zonat e operacioneve.

Të dhënat e siguruara nga ajri mbështesin drejtimin dhe koordinimin e forcave në terren, si dhe reagimin e shpejtë të strukturave përgjegjëse.





Anija “Oriku”, operacione të përbashkëta me fokus garantimin e një sezoni turistik të sigurt

Siguria në det, zbatimi i ligjshmërisë dhe mbarëvajtja e turizmit detar janë në fokus të planit të bashkëpunimit të Forcës Detare/Rojës Bregdetare me Policinë Kufitare dhe Migracionit gjatë këtij sezoni turistik.

Anija “Oriku” P-132, në bashkëpunim me strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit, zhvilloi një operacion të përbashkët në hapësirën detare nga Pashalimani, Gjiri i Vlorës, Gadishulli i Karaburunit e deri në Gjirin e Gramës.



Shqipëria dorëzon komandën e Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG), e pranishme Zëvendësministria e Mbrojtjes Pranvera Skana

Në Stamboll u zhvillua ceremonia zyrtare me rastin e zhvendosjes së Shtabit të Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG), ndërrimit të komandës dhe shënimit të 27-vjetorit të krijimit të saj.

Pas një periudhe 3-vjeçare nën drejtimin e Shqipërisë, gjeneral brigade Bilbil Bitri dorëzoi zyrtarisht komandën e Brigadës së Evropës Juglindore, ndërsa gjeneral brigade Ivan Malamov, nga Bullgaria, mori zyrtarisht detyrën e Komandantit të SEEBRIG.

Në ceremoninë zyrtare morën pjesë Zëvendësministria e Mbrojtjes, Pranvera Skana, si dhe Zëvendësshefja e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Razije Mehmeti.





Novo Selo, Bullgari - efektivët e Forcës Tokësore stërviten me palën italiane, në fokus rritja e gatishmërisë operacionale

Kontingjenti VIII i trupave të Regjimentit të Këmbësonisë së Veriut (RKV), i dislokuar në Novo Selo, Bullgari, në kuadër të misionit të NATO-s “Forward Land Forces”, zhvilloi stërvitje të përbashkët me palën italiane, me tema që përfshinë qitje luftarake, mbrojtje të afërt dhe patrullim gjatë natës.

Përmes trajnimit, u konsoliduan aftësitë individuale dhe kolektive, duke rritur gatishmërinë operacionale dhe zbatimin e standardeve të përbashkëta.





Forca Tokësore në drejtimin e Batalionit Shumëkombësh të EUFOR në Bosnje dhe Hercegovinë

Në Bosnje dhe Hercegovinë, u zhvillua stërvitja shumëkombëshe “Quick Response 2026”, një nga aktivitetet kryesore vjetore të misionit (EUFOR).

Në këtë angazhim shumëkombësh, vendi ynë përmes Forcës Tokësore, mbajti një përgjegjësi të veçantë në strukturën operacionale të EUFOR-it, duke drejtuar Batalionin Shumëkombësh të Rezervës Operacionale.

Reparti, i drejtuar nga personeli i Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë të Forcës Tokësore krahas kontributit me trupa, mori përsipër edhe përgjegjësinë e drejtimit të një formacioni të përbërë nga elementë ushtarakë të vendeve të ndryshme.



Letoni, kontingjenti shqiptar XIX EOD vijon me sukses misionin

Kontingjenti shqiptar XIX EOD, i atashuar pranë Brigadës Shumëkombëshe në Letoni, vijon me profesionalizëm dhe përkushtim realizimin e detyrave të ngarkuara.

Efektivët e Togës EOD ndërhyjnë për kontrollin dhe pastrimin e një zone të identifikuar me prani të municioneve të paplasura.

Përmes kontrollit manual dhe përdorimit të aparaturave metalkërkuese, efektivët tanë identifikuan, vlerësuan dhe transportuan në mënyrë të sigurt një sasi të konsiderueshme municionesh të kalibrave të ndryshëm.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

www.mod.gov.al

